


Cilindri. Prerjet e cilindrit në rrafsh

Cilindër quhet pjesë e sipërfaqes cilindrike e cila ndodhet ndërmjet dy rrafsheve paralele.

Elementet e cilindrit janë:

- baza(të dy rrahët)
- sipërfaqja anësore(mbështjellësi i cilindrit)
- boshti i cilindrit(lartësia)
- rrezja(r)



Dallojmë dy lloje të prerjes së cilindrit me rrafsh:

- paralele
- boshtore-

Pyetje

1. Çka është cilindri?
2. Cilët janë elementet e cilindrit?
3. Si mund të jetë prerja e cilindrit me rrafsh?

Syprina dhe vëllimi i cilindrit

Syprina anësore e cilindrit llogaritet me formulën:

$$M = 2rh\pi$$

Syprina e cilindrit llogaritet me formulën:

$$S = 2B + M = 2r^2\pi + 2rh\pi = 2r\pi(r + h)$$

Vëllimi I cilindrit llogaritet me formulën :

$$V = r^2 h \pi$$

Detyra

1 Drejtkëndëshi me dimensione $a = 10\text{cm}$ dhe $b = 6\text{cm}$ rrotullohet rreth brinjës më të madhe. Njehso syprinën dhe vëllimin e trupit të atillë të fituar.

2. Jepet cilindri me rreze 14 cm dhe lartësi 20 cm .

Gjeni:

a) Sipërfaqen anësore të cilindrit

- b) Sipërfaqen e bazës së cilindrit
- c) Vëllimin e cilindrit

3. Jepet cilindri me rreze 15 cm dhe lartësi 40 cm.

Gjeni:

- a) Sipërfaqen anësore të cilindrit
- b) Sipërfaqen e bazës së cilindrit
- c) Vëllimin e cilindrit


Koni. Prerja e konit me rrafsh

Nëse r është rrezja e bazës, h lartësia dhe s gjatësia e përfuteses atëherë kemi:

$$r^2 + h^2 = s^2$$

Elementet e konit janë:

- baza(rrethi)
- sipërfaqja anësore(mbështjellësi konik)
- rrezja(r)
- boshti(lartësia)



Prerja e konit me rrafsh quhet:

- paralele- kur rrafshi është paralel me bazën e konit
- boshore- kur rrafshi kalon nëpër prerjen e boshtit

Pyetje dhe detyra

1. Shëno si mund të jetë prerja e konit në rrafsh?
2. Prej cilave pjesë përbëhet koni?
3. Shëno formulën për gjatësinë e përfuteses.
4. Larësia e një koni është $h=10\text{cm}$ ndërsa rrezja $r=6\text{cm}$. Njihso gjatësinë e përfuteses.
5. Larësia e një koni është $h=13\text{cm}$ ndërsa rrezja $r=5\text{cm}$. Njihso gjatësinë e përfuteses.

Syprina dhe vëllimi i konit

Syprina anësore e konit llogaritet me formulën:

$$M = rs\pi$$

Syprina e konit llogaritet me formulën:

$$S = B + M = r^2\pi + rs\pi = r\pi(r + s)$$

Vëllimi i konit llogaritet me formulën:

$$V = \frac{1}{3}r^2h\pi$$

Detyra

1. Njehso syprinën anësore të konit me lartësi $h=20$ cm dhe rreze $r=10$ cm.
2. Njehso syprinën anësore të konit me lartësi $h=5$ cm dhe rreze $r=4$ cm.
3. Njehso syprinën e konit me lartësi $h=15$ dhe përfutuese 12cm.
4. Njehso vëllimin e konit me rreze 14cm dhe mbështjellës 175cm.
5. Njehso vëllimin e konit me lartësi $h=6$ cm dhe $r=5$ cm.
6. Njehso vëllimin e konit me lartësi $h=6.3$ cm dhe rreze $r=7.5$ cm.
7. Njehso syprinën e konit rreze $r=6$ cm dhe përfutuese $s=10$ cm.

Detyrat e zgjedhura i dërgoni në email lorie_memeti@hotmail.com

Për çdo paqartësi mos hezitoni të më shkruani.